



Si të strukturoni një **letër** motivuese

Një letër e mirë motivuese zakonisht është **jo më shumë se një faqe**, ku ju prezantoni veten, historinë tuaj, dhe tregoni interesin për pozitën ose vendin ku po aplikoni.

Ekzistojnë **dy mënyra** kryesore për të strukturuar letrën tuaj motivuese:

1. Përdorimi i strukturës klasike të 3 paragrafëve, ku letra juaj motivuese ka hyrjen, përmbajtjen dhe përfundimin.
2. Duke përdorur strukturën e paragrafëve 5-7, ku ju ndani përmbajtjen në disa fjali-paragrafë sipas pikave kryesore.

Për cilëndo strukturë që ju të vendosni, ajo duhet të përbëhet nga **3 pjesë kryesore**:

1. hyrja,
2. përmbajtja, dhe
3. përfundimi.

Ja çfarë duhet të përfshini në secilën prej tyre:

Hyrje: *një fjali e shkurtër, tërheqëse, për veten tuaj dhe pse po aplikoni*

Këtu mund të përfshini:

- Informata personale. Kush jeni ju dhe çfarë bëni?
- Për çfarë po aplikoni? Ku?
- Një hyrje në pjesën më të madhe të esesë tuaj. Përmendni arsyen e përgjithshme se pse po aplikoni, dhe pastaj zhytuni thellë në pjesën kryesore të letrës tuaj motivuese.

Shembull i hyrjes për letrën motivuese

I nderuari [Emri i Personit të Kontaktit],

Unë jam [Emri juaj] dhe shpreh interesimin tim për të aplikuar për programin e Doktoratës në shkencat politike në [Emri i Universitetit]. Unë gjithmonë kam ëndërruar të punoj në fushën akademike dhe të ndihmoj vendin tim pas kthimit në Kosovë, dhe besoj se programi në shkencë politike nga [Emri i Departamentit] do të më ndihmonte përpara për të arritur vizionin tim.

Përmbajtja e Letrës Motivuese

Kjo është pjesa kryesore e letrës tuaj motivuese. Kjo është ajo pjesë ku ju me të vërtetë reklamoni veten, duke përmendur historinë prapa arritjeve, aftësive, dhe pasionit tuaj për çdo gjë për të cilën po kërkon.

Mundohuni të jeni sa më faktikë të jetë e mundur. Kur është e aplikueshme, ju gjithashtu mund të përdorni të dhëna për të mbështetur kualifikimet tuaja.

Ja një Shembull Praktik

Kam zhvilluar pasionin tim për marketingun online gjatë praktikës që kam kryer në [emrin e kompanisë]. Puna në një start-up të vogël më mundësoi të marr përvojë në nivelin fillestar në shumicën e kanaleve digjitale të marketingut. Tani, unë kam dëshirë të fitoj njohuri të avancuara duke marrë pjesë në programin [emri i universitetit] në Marketing Digjital.

Përfundimi

Në këtë pjesë, ju mund të finalizoni letrën motivuese dhe ta dërgoni. Në këtë seksion, mund të:

- Përmbliidhni shkurtimisht pikat tuaja kryesore
- Përmendni qëllimin tuaj gjithëpërfshirës
- Falënderojë lexuesin dhe përmbyll letrën motivuese.

Tani që e dini se si të strukturoni një letër motivuese, le të kalojmë në përmbajtje!

Si të shkruajmë një letër fituese motivuese?

Mënyra më e mirë për të shmangur përgjithësimet dhe për të shtuar thellësinë e letrës suaj motivuese është duke e përshtatur atë me organizatën dhe programin/pozitën specifike për të cilin po aplikoni:

- Kur shkruani një letër motivuese, ju duhet të siguroheni se dini për çfarë dhe ku po aplikoni
- Lexoni kërkesat e programit apo kriteret në oferta pune dhe faqen e internetit të institucionit
- Gjeni tri kërkesat kryesore për pozitën dhe shpjegoni sesi ju jeni kandidati më i mirë.

Letra juaj motivuese duhet të tregojë se ju vërtet dëshironi të punoni apo studioni aty. Tregoni arsyet specifike, demonstroi njohuri, dhe shprehni pasionin për të aplikuar në atë institucion ose organizatë.

MOS GENJE!

Nëse shkruani ndonjë të pavërtetë, lexuesi juaj do ta kuptojë atë. Në mënyrë të pavetëdijshme, ne fryjmë ndjenjat dhe idetë kur gënjejmë. Nëse tregoni një histori të rreme ose ekzagjeroni arritjet tuaja, konsideroni se kërkesa juaj u refuzua.

Pyetje për t'u përgjigjur në letrën tuaj motivuese

Çfarë ju motivoi të aplikoni për këtë pozitë apo program specifik?

1. Do të më pëlqente të jetoja në [vendndodhjen e kompanisë], sepse _____
2. Është ëndrra ime të jem pjesë e [emrit të programit], sepse _____